

NEWSLETTER

KORRIK-TETOR



KAMPUSI UNIVERSITAR

Rr. Ukshin Kovaçica, p.n, 40000, Mitrovicë, Kosovë

Web: www.umib.net

Email: info@umib.net

Facebook: Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"

Instagram: [umib_net](https://www.instagram.com/umib_net)

Tel: 00383 (0)28 535 726

TAKIM INFORMUES LIDHUR ME PROCESIN E APLIKIMIT PËR RIAKREDITIM TË PROGRAMEVE



Mbështetur në planin e punës lidhur me procesin e aplikimit për riakreditim të programeve, të mërkurën në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB), është mbajtur një takim informues. Prorektorja për Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe Zhvillim të Cilësisë, Merita Shala, në takim me grupet punuese nga të gjitha fakultetet, ka dhënë sqarime për Raportin e Vetëvlerësimit për programe sipas udhëzimeve të Agjencisë për Akreditim të Kosovës (AKA).

Anëtarët e grupeve punuese u shprehën të kënaqur me dinamikën e punëve sa i përket procesit të riakreditimit të programeve. Përndryshe në kuadër të UMIB-it aktualisht janë të akredituara 20 programe në nivelin bachelor dhe master.

01.07.2020

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME PRISHTINA REA



Me qëllim të zhvillimit të arsimit, aftësimit profesional, punës praktike etj, Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB) do të bashkëpunoj me Prishtina REA. Për të konkretizuar fushën e veprimit, rektori i UMIB-it, Alush Musaj dhe drejtori i Prishtina REA, Ahmet Jetullahu-Meti, nënshkruan të premtën edhe një Marrëveshje Bashkëpunimi.

Në kuadër të Marrëveshjes janë përcaktuar edhe përgjegjësitë e secilës palë. Sipas kësaj, UMIB-i do të njoftoj Prishtina REA-n për mundësitë e bashkëpunimit në projekte të përbashkëta. Poashtu parashihet që UMIB-i të ftoj për bashkëpunime zhvillimore, menaxhmentin dhe bashkëpunëtorët e Prishtina REA.

Ndërsa, Prishtina REA, do të ofroj informata në lidhje me fushat e aftësimit profesional, shkencat e aplikuara, industrinë minerare, ushqimore etj. Prishtina REA do të ndërmarrë rol aktiv në promovimin e mundësive për partneritet të UMIB-it.

Marrëveshja është konsideruar si një nismë e mirë për UMIB-in dhe Prishtina REA. Rektori Musaj dhe drejtori Jetullahu, shprehën zotimin e tyre për jetësimin e kësaj Marrëveshje në të mirë të studentëve dhe stafit akademik të UMIB-it si dhe aktivitetit të Prishtina REA.

03.07.2020

UMIB PJESË E PROJEKTIT PËR MOBILITET ME UNIVERSITETIN “VAN HALL LARENSTEIN” NË HOLANDË



Universiteti “Van Hall Larenstein” në Holandë ka fituar një projekt për mobilitet nga Erasmus+, ku për partner ka Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB), përkatësisht Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore (FTU) dhe UBT-në. Ky projekt që vlerësohet shumë i rëndësishëm për studentët dhe stafin e FTU-së, fillon më 1 shtator 2020 dhe zgjat deri më 31 korrik 2023.

Dekani i FTU-së, Milaim Sadiku, tha se me Universitetin “Van Hall Larenstein” kanë tashmë një traditë shumë të suksesshme bashkëpunimi që për fat të mirë do të vazhdoj. “Jemi shumë të lumtur që do të vazhdojmë bashkëpunimin me një universitet që na ka ofruar mundësi të mëdha për studentët dhe stafin tonë”, tha ai.

Në kuadër të projektit, parashihet që në periudhën 3-vjeçare në Universitetin “Van Hall Larenstein”, të studiojnë gjithsej 32 studentë nga Kosova me kohëzgjatje prej 5 muajsh, ndërsa në Kosovë për të studiuar do të vijnë 4 studentë nga Holanda, ku do të qëndrojnë nga 5 muaj. Gjithashtu në kuadër të projektit parashihet edhe mobiliteti i stafit akademik.

07.07.2020

REKTORI MUSAJ, ANËTAR I
KOMISIONIT TË NDERIT NË
“SIMPOZIUMIN
NDËRKOMBËTAR PËR
SHKENCAT E MJEDISIT DHE
HULUMTIMET INXHINIERIKE”

<https://iseser.com/>




Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB), është bërë pjesë e organizimit të “Simpoziumit ndërkombëtar për shkencat e mjedisit dhe hulumtimet inxhinierike”, që është mbajtur në Manisa të Turqisë. Në këtë kontekst, rektori i UMIB-it, prof.dr.Alush Musaj, ka qenë pjesë e Komisionit të Nderit në botimin e përgatitur me abstraktet e këtij simpoziumi.

Në këtë aktivitetet shkencor, janë paraqitur me punimet e tyre rreth 50 studiues nga vende të ndryshme të botës. Rektori Musaj, tha se përfshirja në organizimin e kësaj ngjarje të rëndësishme për shkencat e mjedisit, rrit imazhin e UMIB-it në rajon dhe më gjerë.

Sipas tij, këto aktivitete janë të mirëseardhura për zhvillimin e UMIB-it dhe rritjen e bashkëpunimit me universitete prestigjioze nga e gjithë bota. “Të jesh pjesë e organizimit të një ngjarje të tillë, ku marrin pjesë universitete dhe njerëz të shkencës nga e gjithë bota, padyshim se është një lajm jashtëzakonisht i mirë për të ardhmen e UMIB-it”.

09.07.2020

U MBAJT WEBINARI “SHKATHTËSITË E PREZANTIMIT”



Organizuar nga Qendra për Zhvillim të Karrierës (QZHK) dhe GIZ-i është mbajtur të premtën webinarri “Shkathtësitë e prezantimit” me studentët e Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB). Në webinar janë kyçur mbi 30 studentë, të cilët kanë pasur rastin të dëgjojnë ekspertët e fushës së shkathtësive të prezantimit.

Zyrtari i QZHK-së, Alban Fazliu, është shprehur i kënaqur me pjesëmarrjen e studentëve në këtë aktivitet të rëndësishëm për ngritjen profesionale. Ai ka falënderuar GIZ-in për mbështetje sa i përket punës së QZHK-së.

Ndryshe, bashkëpunimi ndërmjet QZHK-së dhe GIZ-it tashmë është kanalizuar në aktivitete të shpeshta, duke ofruar mundësi shumë të mira për studentët e UMIB-it. Këshilltari i GIZ-it, Nexhmedin Basha, ka vlerësuar përkushtimin e QZHK-së për organizimin e mirë sa i përket këtyre trajnimeve për studentë.

10.07.2020

U MBAJT ONLINE KONFERENCA E REKTORËVE



Konferenca e Rektorëve ka mbajtur të premtën takimin e radhës online, ku u diskutua për procesin e akreditimit të programeve studimore. Gjithashtu u diskutua edhe për vazhdimin e provimeve të studentëve për afatin e qershorit në situatën e vështirësuar nga pandemia me Covid-19.

Rektorët u dakorduan që të shtohen maksimalisht masat e sigurisë nëpër objektet universitare, në mënyrë që të mund të përfundojnë provimet. U shtrua edhe mundësia e organizimit të universiteteve për filimin e vitit të ri akademik në formatin online, nëse nuk kalon pandemia Covid -19.

Në Konferencën e Rektorëve u fol edhe për situatën e rëndë të krijuar në muajt e fundit si në shëndetësi, në ekonomi dhe në politikën e Kosovës dhe ajo do të miratojë një deklaratë për unitetin e klasës politike në të mirë të interesit nacional.

10.07.2020

MODERNIZOHET AMBIENTI I BRENDSHËM NË UMIB



Përveç investimeve në objektet e kampusit universitar, në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB), janë duke u krijuar kushte jashtëzakonisht të mira edhe në ambientet e brendshme. E gjitha është duke krijuar një hapësirë shumë moderne dhe tepër të përshtatshme pune për studentët, stafin akademik dhe administratën.

Rektori i UMIB-it, prof.dr.Alush Musaj, tha se në hollin e objektit ku janë fakultetet, është rregulluar recepcioni, mandej janë vendosur vitrina ku do të ekspozohen materiale të fakulteteve si dhe kënde moderne për studentë. “Në përgjithësi edhe ambientet e brendshme kanë marrë një imazh shumë modern dhe gjithsesi se kanë krijuar kushte të mira për gjithë komunitetin universitar”, tha ai.

Në kuadër të këtyre investimeve, është rregulluar dhe pajisur me mjete të nevojshme edhe biblioteka universitare. Përveç bankave dhe karrigeve, janë siguruar edhe kompjuterë për studentët që kanë nevojë për ushtrime.

16.07.2020

U NDANË GRANTET PËR BIZNES-PLANET MË TË MIRA



Në kuadër të projektit të financuar nga BE-ja, “Fuqizimi i të rinjve dhe grave ndërmarrëse” dhe të implementuar nga “Caritas Kosova” dhe Qendra për Inovacion dhe Ndërmarrësi (IECM) në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB), të premtën janë ndarë grantet për përfituesit e biznes-planeve më të mira. Përzgjedhja e tyre është bërë nga një komision i përbashkët i “Caritas Kosova” dhe IECM-së.

Ndryshe në kuadër të këtij projekti, një numër i konsiderueshëm i të rinjve dhe grave ndërmarrëse, janë trajnuar dhe përgatitur për planet e tyre të biznesit. Si rrjedhojë, projekti është vlerësuar jashtëzakonisht i suksesshëm nga të gjithë.

Drejtori i IECM-së, Besart Hajrizi, tha se bashkëpunimi që kanë pasur me “Caritas Kosova” është treguar shumë i frytshëm. “Jemi shumë të motivuar me suksesin e këtij projekti dhe presim që edhe në të ardhmen të vazhdohet me projekte të tjera në të mirë të ndërmarrësve të rinj në rajon dhe më gjerë”, tha ai.

17.07.2020

FAKULTETI JURIDIK I
UMIB-IT
BASHKËPUNON ME
FAKULTETIN JURIDIK
TË OSJEKUT



Stafi akademik dhe studentët e Fakultetit Juridik në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB), do të bashkëpunojnë me kolegët e tyre nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Osjekut në Kroaci, në projekte të përbashkëta të hulumtimeve shkencore. Me qëllim të konkretizimit të bashkëpunimit është nënshkruar edhe një marrëveshje nga dekani, prof.asoc.dr. Agron Beka dhe homologu i tij nga Kroacia, prof.dr.Tunjica Petrasiç.

Në kuadër të kësaj marrëveshje parashihet bashkëpunimi ndërmjet stafit akademik dhe studentëve për nivelin bachelor, master dhe doktoraturë. Dekani Beka, e vlerësoi si një marrëveshje që do të ndihmoj stafin akademik dhe studentët e të dyja fakulteteve për shkëmbimin e përvojave dhe avancimin profesional.

21.07.2020

ISH-STUDENTJA E UMIB-IT LOBON PËR LIBERALIZMIN E VIZAVE PËR KOSOVËN



Ish-studentja e Fakultetit Juridik në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”(UMIB), Albulena Uka, e cila më pas ka kryer studimet në nivelin master në Universitetin e Gentit në Belgjikë, ka zhvilluar një takim me deputeten e Parlamentit Evropian, Violavon Cramon, e cila është raportuese për Kosovën. Albulena, e cila është mbesë e heroit, Mehë Uka, ka lobuar për liberalizmin e vizave për qytetarët e Kosovës.

Në një postim në fejsbuk, ish-studentja e UMIB-it është shprehur e lumtur për këtë takim me raportuesen për Kosovën në Parlamentin Evropian. Përndryshe kjo e re mitrovicase, ishte nderuar nga UMIB-i për suksesin e saj si studente, duke diplomuar me notën mesatare 10, në Fakultetin Juridik.

21.07.2020

PROJEKT PËR REALIZIMIN E PUNËS PRAKTIKE NË FAKULTETIN E EDUKIMIT



Në kuadër të projektit “Shpresë”, të realizuar nga Caritasi Zviceran në bashkëpunim me Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB), në Fakultetin e Edukimit është krijuar klasa parashkollore me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të edukatorëve të ardhshëm në edukimin parashkollor rreth qasjeve bashkëkohore në APF. Si rrjedhojë një klasë është pajisur me inventarë dhe pako të lodrave nga druri, që do të shërbej për realizimin e aktiviteteve dhe punës praktike të studentëve tanë.

Dekani i Fakultetit të Edukimit, prof.ass.dr. Besim Gollopeni, ka falënderuar ekipin e projektit “Shpresë” për mbështetjen dhe ju ka ofruar bashkëpunim të vazhdueshëm edhe në projektet tjera në interes të studentëve, stafit dhe komunitetit në përgjithësi.

22.07.2020

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME AGJENCINË PËR ZHVILLIM RAJONAL – VERI



Me qëllim të krijimit të mundësive me të mëdha për trajnimin e studentëve në fusha të ndryshme me interes për ngritjen e tyre profesionale, Qendra për Zhvillim të Karrierës (QZHK) në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB) do të bashkëpunoj ngushtë me Agjencinë për Zhvillim Rajonal – Veri (ARZHV). Për konkretizimin e obligimeve dhe përgjegjësive për secilën palë, të premtën është nënshkruar edhe një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet UMIB-it dhe ARZHV-së të përfaqësuar nga rektori, Alush Musaj dhe drejtoresha ekzekutive, Rreze Duli.

Marrëveshja u vlerësua si rrjedhojë e interesit reciprok, por edhe atë të përbashkët në të mirë të komunitetit, UMIB-it dhe ARZHV-së. Në bazë të kësaj marrëveshje synohet që të lehtësohet realizimi i nismave dhe projekteve të ndryshme që ndërlidhen me natyrën e UMIB-it dhe karakterin e aktiviteteve që realizon AZHRV-ja.

24.07.2020

Rektori Musaj, tha se përfitues do të jenë studentët e UMIB-it dhe të rinjtë e rajonit që do t’u mundësohet pjesëmarrja në trajnime dhe aktivitete që kanë të bëjnë me avancimin profesional si dhe AZHRV-ja, që do të shfrytëzoj kapacitetet e UMIB-it për këto aktivitete. “UMIB-i, përkatësisht QZHK-ja do të përkujdeset për njoftimin dhe organizimin e studentëve dhe të rinjve për aktivitetet që organizon AZHRV -ja në UMIB, në mënyrë që pjesëmarrja të jetë në nivel”, tha ai.

KONVIKTI DHE MENSA PLANIFIKOHET TË JENË GATI NË TETOR TË VITIT 2021




Rektori i Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, prof.dr.Alush Musaj, ka vizituar vendpunishten ku është duke u ndërtuar konvikti dhe mensa e studentëve në kampusin universitar. Ai ka parë për së afërmi punën që është bërë deri me tani në ndërtimin e këtyre dy objekteve, të cilat planifikohet të kryhen në tetor të vitit të ardhshëm.

Rektori u njoftua nga përgjegjësit e kompanisë që është duke kryer punimet se gjithçka është duke shkuar mirë dhe sipas dinamikës së paraparë. Ata gjithashtu theksuan se në bazë të ecurive të punimeve objektet do të jenë gati ashtu siç është planifikuar.

27.07.2020

Ndërtimin e këtyre dy objekteve në kampusin universitar, rektori Musaj, e ka vlerësuar shumë të rëndësishme për UMIB-in. Sipas tij, konvikti dhe mensa do të krijojnë kushte edhe më të mira për studentët dhe në përgjithësi do të kompletojmë infrastrukturën e UMIB-it.

UMIB-I RANGOHET I DYTI NË NIVEL VENDI NGA WEBOMETRICS



Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB) është renditur i dyti në nivel vendi edhe në përditësimin e fundit në ranglistën e institucioneve të arsimit të lartë në botë të publikuar nga Webometrics (Spanish National Research Council). Në mesin e 29 mijë universiteteve nga i gjithë globi, UMIB është renditur në vendin e 12970.

UMIB-i është pozicionuar në vendin e dytë pas Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, në nivel vendi. Rektori, Alush Musaj, tha se ky është një lajm që tregon për punën e mirë që po bëhet në UMIB”.

Sipas tij, sukseset e UMIB-it vetëm sa po vijnë e shtohen dhe kjo si rrjedhojë e punës dhe angazhimit të madh. “Duke pasur parasysh rrethanat dhe sfidat me të cilat jemi përballur, ky rangim është një arritje që na gëzon dhe na motivon për të ecur tutje”, tha ai.

27.07.2020

RAPORTI I AUDITIMIT PA VËREJTJE PËR UNIVERSITETIN “ISA BOLETINI”



Zyra Kombëtare e Auditimit nuk ka bërë asnjë vërejtje për Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”(UMIB), sa i përket vitit fiskal 2019. Në pjesën e raportit për UMIB-in si nënprogram i MASHT-it, auditori gjatë ekzaminimit të dokumentacionit të prezantuar bazuar në standardet e aplikuara ka dhënë opinion të pamodifikuar.

Në raport, auditori nuk ka adresuar asnjë çështje me arsyetim se dokumentacioni dhe dosjet e kërkuara janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtimin me kornizën e zbatueshme financiare. Vlerësim të njëjtë auditori kishte bërë edhe vitin e kaluar për UMIB-in.

Rektori i UMIB-it, prof.dr.Alush Musaj, tha se ky është edhe një lajm tjetër i mirë që tregon për punën profesionale në këtë institucion të arsimit të lartë në Kosovë, pas lajmit për riakreditim dhe rangim në webometrics. “Tashmë është bërë traditë që raportet e auditimit të jenë pa vërejtje për UMIB-in dhe kjo si rezultat i punës profesionale të stafit përgjegjës”, tha ai.

Ndërsa, drejtori për Buxhet dhe Financa në UMIB, Besim Kurti, sqaroi se procesi i auditimit ishte i bazuar në dokumentet që rregullojnë funksionimin financiar. “Në këtë kontekst, objekti i kontrollit ishin planifikimi, menaxhimi, shpenzimet, burimi i të hyrave dhe kontrolli financiar i aktiviteteve të realizuara në të gjitha kategoritë ekonomike”.

29.07.2020

URIMI I REKTORIT,
PROF.DR.ALUSH
MUSAJ, PËR KURBAN
BAJRAM



Të nderuar studentë, mësimdhënës, punëtorë të administratës të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" dhe ju besimtarë mysliman, më lejoni t'ju uroj Kurban Bajramin.

Le të na shërbej kjo festë për të rritur ndjenjën humane dhe respektin reciprok me njëri-tjetrin. Të jetojmë përditë sipas porosisë së kësaj feste, duke bërë që shoqëria jonë të shquhet me vlerat që i ka pasur e me të cilat është identifikuar. Në fund më lejoni t'ju uroj shëndet, paqe e lumturi në jetë dhe në familjet tuaja!

Me respekt!

30.07.2020

UMIB-I PËRFITON DY PROJEKTE NË KUADËR TË PROGRAMIT ERASMUS+



Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”(UMIB) ka fituar dy projekte në kuadër të programit Erasmus+. Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Kërkime Shkencore, prof.dr.Behxhet Shala, tha se deri me tani janë njoftuar se kanë kaluar dy projekte, në të cilat UMIB-i është partner.

Sipas tij, UMIB-i ka përfituar si partner në projektin “Fokusi në sigurinë e ushqimit”, ku bartës është Universiteti Lindor i Finlandës, ndërsa projekti tjetër është “Kurrikula të dyfishta – Puna dhe Studimi në Bujqësi dhe Agrobiznes”, ku bartës ka qenë Universiteti “Hochschule Nürtingen” në Gjermani. “Ne kemi aplikuar gjithsej në 10 projekte për ndërtim kapacitetesh dhe 5 për mobilitet”, tha ai.

Rektori i UMIB-it, prof.dr.Alush Musaj, tha se projektet që janë realizuar këto vite në kuadër të programit të Erasmusit+ kanë pasur ndikim të madh në ngritjen e përgjithshme të cilësisë në universitet. “Projektet që janë realizuar qoftë si bartës, qoftë si partner me universitete tjera, kanë ofruar mundësi të mëdha për studentët dhe stafin akademik”, tha ai.

Rektori Musaj, tha se vazhdimisht kanë inkurajuar studentët dhe stafin akademik të shfrytëzojnë këto mundësi, meqë janë një mënyrë shumë e mirë për ngritje profesionale. “Jemi jashtëzakonisht të kënaqur me këto projekte dhe shpresojmë se studentët dhe stafi akademik do të përfshihen edhe më tepër në to”.

02.08.2020

FILLOI TRAJNIMI PËR DIZAJN GRAFIK DHE WEB-DIZAJN



Në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB), ka filluar trajnimi për dizajn grafik dhe web-dizajn, me rreth 50 studentë dhe të rinj të rajonit. Trajnimi është organizuar nga Agjencia Rajonale e Zhvillimit – Veri (ARZHV) në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillim të Karrierës (QZHK) në UMIB dhe financohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Në hapje të trajnimit në UMIB ka qëndruar edhe ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, e cila është interesuar për organizimin e këtij aktiviteti. Ajo i ka përshëndetur pjesëmarrësit e trajnimit, të cilëve ju ka uruar sukses, përderisa ka falënderuar UMIB-in dhe ARZHV për organizimin e mirë. “Ne jemi të vendosur që të mbështesim nismat dhe projektet në të mirë të rinisë”, tha ajo.

Drejtori për Informim dhe Komunikim me Publikun, Ahmet Jashari, i ka uruar mirëseardhje ministres Dumoshi në UMIB dhe e ka falënderuar për mbështetjen sa i përket këtij aktiviteti në këtë kohë pandemie. “Jemi shumë të kënaqur me pjesëmarrjen e të rinjve në këtë trajnim dhe për faktin se mund të ofrojmë kushte kaq të mira për ata që duan të avancohen në aspektin profesional”, tha ai.

Ndërsa, drejtoresha ekzekutive e ARZHV-së, Rreze Duli, falënderoi ministren Dumoshi, drejtorin Jashari dhe zyrtarin e QZHK-së, Alban Fazliu, për përkushtimin sa i përket jetësimit të këtij aktiviteti në të mirë të studentëve dhe të të rinjve. Ajo sqaroi se trajnimi ka gjithsej 54 orë, ndërsa në fund pjesëmarrësit do të pajisen me certifikata ku planifikohet të organizohet edhe një ceremoni rasti.

08.08.2020

MINISTRI I ARSIMIT VIZITOI UNIVERSITETIN “ISA BOLETINI”



Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj dhe kryetarja e Komisionit për Arsim dhe Shkencë, Valentina Bunjaku- Rexhepi, kanë vizituar të hënën Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB). Ata u pritën në takim nga rektori i UMIB-it, Alush Musaj, me të cilin diskutuan për sfidat dhe të arriturat e këtij universiteti.

Rektori Musaj, i falënderoi mysafirët për vizitën dhe i njoftoi ata me rrugëtimin e arsimit të lartë në Mitrovicë. Ai theksoi se përkundër sfidave, përvoja e gjatë akademike ka bërë që UMIB-i të shndërrohet në një tregim suksesi për një kohë relativisht të shkurtër.

Ai gjithashtu vlerësoi qasjen korrekte të ministrit Likaj, sa i përket shtytjes për miratimin në Kuvendin e Kosovës të Statutit të UMIB-it, duke qenë se Statuti i Përkohshëm, në bazë të të cilit funksionon UMIB-i, por edhe disa universitete tjera publike në Kosovë, tashmë janë shndërruar në pengesë për zhvillimin e këtyre universiteteve.

Në anën tjetër, ministri Likaj, bëri të ditur se ata kanë proceduar draftstatutin në qeveri dhe pas procedurave të zakonshme do të kaloj në Komisionin përkatës të Kuvendit të Kosovës. “Jemi duke punuar që të krijojmë kushte sa më të mira pune për këto universitete, prandaj në këtë kontekst kemi shtyrë përpara edhe miratimin e statuteve të tyre”, tha ai.

31.08.2020

REKTORI MUSAJ, OFRON BASHKËPUNIM PËR ORGANIZATËN “DREJTËSI PËR TË GJITHË”



Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB) do të bashkëpunoj ngushtë me organizatën “Drejtësi për të gjithë”, që mbron të drejtat e të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë. Për këtë janë pajtuar rektori i UMIB-it, prof.dr.Alush Musaj dhe drejtori ekzekutiv i organizatës “Drejtësi për të gjithë”, Nafi Krasniqi.

Gjatë vizitës në UMIB, Krasniqi e ka njoftuar rektorin Musaj me aktivitetet e organizatës që ai drejton. Në këtë kontekst, ka folur edhe për nevojën e bashkëpunimit me universitetet në mënyrë që të organizohen aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me luftimin e stigmës për këtë kategori.

Ai theksoi se në kuadër të universiteve publike, por edhe kolegjeve private mund të organizohen seminare që kanë të bëjnë me luftimin e stigmës për të mbijetuarat e dhunës seksuale. “Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e kësaj kategorie, universitetet do të mund të bënin punë të mirë për senzibilimin e shoqërisë”, tha ai.

Rektori Musaj, e ka vlerësuar punën e kësaj organizate dhe ka ofruar mbështetje të plotë. “Jemi të gatshëm që të japim kontributin tonë dhe të ofrojmë krejt mundësitë tona që të ndihmojmë këtë kategori”, tha ai.

04.09.2020

GATISHMËRI PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË PËRBASHKËTA NGA UNIVERSITETI “ISA BOLETINI” DHE AI “FEHMI AGANI”



Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB) dhe Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani” (UGJFH), do të bashkëpunojnë ngushtë për hapjen e programeve të përbashkëta në të mirë të studentëve. Për këtë u bisedua të premtën në një takim të përbashkët të rektorit të UMIB-it, Alush Musaj dhe atij të UGJFA-së, Artan Nimanit, i cili vizitoi kampusin universitar në Mitrovicë.

Rektori Musaj, e falënderoi për vizitën homologun nga Gjakova, dhe shprehu gatishmërinë për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy universiteteve. Ai theksoi se kapacitetet që kanë këto dy universitete në këtë rast, por edhe universitetet tjera publike, por ato private duhet të ofrohen në të mirë të studentëve dhe stafit akademik pa përjashtim. “Jemi të hapur dhe të gatshëm për bashkëpunim në të mirë të ngritjes profesionale të studentëve tanë, duke shfrytëzuar mundësitë që ofrojnë universitetet tona”, tha ai.

Në anën tjetër, rektori Nimani, tha se është në interesin e dy institucioneve që të hapet ndonjë program i përbashkët. Në këtë kontekst, ai falënderoi rektorin Musaj për mbështetjen e ofruar. “Jemi shumë të kënaqur me dakordimin për intensifikimin e bashkëpunimit”, tha ai.

18.09.2020

UMIB-I PËRFITON NJË PROJEKT PËR MOBILITET NË KUADËR TË PROGRAMIT ERASMUS+



Në kuadër të Programit Erasmus +, Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB), është përfitues si partner në një projekt me Universitetin e Teknologjisë në Poloni që ka të bëjë me mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik. Projekti do të zgjas dy vjet dhe pritet të fillojë në semestrin dimëror 2020/21.

Planifikohet që mobiliteti për staf akademik të zhvillohet në semestrin dimëror 2020/21, ndërsa mobiliteti për studentë në semestrin veror 2020/21. Dinamika e zhvillimit të projektit parashihet të jetë fleksibile për shkak të pandemisë me Covid-19.

Ky dhe projekte të tjera që ka përfituar UMIB-u në kuadër të Programit Erasmus +, vlerësohen shumë të rëndësishme sa i përket mundësive që ofrojnë për studentët dhe stafin akademik.

18.09.2020

UMIB HAP KONKURS PËR PRANIMIN E
STUDENTËVE NË VITIN E PARË (NIVELI
BACHELOR) – VITI AKADEMIK 2020/2021



21.09.2020

MIRËNJOHJE PËR KONTRIBUT NË PROCESIN E RIAKREDITIMIT TË UMIB-IT



Në një ceremoni të organizuar nga Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB), janë nderuar me mirënjohje përfaqësues të industrisë, studentë, profesorë dhe të gjithë ata që kanë qenë pjesë e grupit për riakreditim të UMIB-it. Rektori, prof.dr. Alush Musaj, ka falënderuar të gjithë për kontributin e tyre sa i përket procesit të riakreditimit institucional.

Ai tha se puna ekipore dhe bashkëpunimi korrekt ka bërë që procesi të shkoj mirë dhe UMIB-i të riakreditohet për një periudhë 3-vjeçare. “Jemi jashtëzakonisht mirënjohës për të gjithë”, tha ai.

24.09.2020

DITË INFORMUESE PËR TË STUDIUAR NË UMIB



Tre grupe studentësh, të organizuar nga Qendra për Zhvillim të Karrierës dhe Parlamenti Studentor i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB), kanë mbajtur të enjten ditë informuese në Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri, për të gjithë ata që duan të studiojnë në UMIB. Të interesuarit janë informuar për kushtet që ofron UMIB-i, duke nisur nga kampusi që është më i miri në vend, mandej programet atraktive që sigurojnë punësim, bursa, vazhdim të studimeve jashtë vendit etj.

24.09.2020

Alban Fazliu, zyrtar i Qendrës për Zhvillim të Karrierës, tha se ka qenë një ditë shumë e ngjeshur dhe frytdhënëse për UMIB-in. “Grupet e studentëve tanë janë pritur jashtëzakonisht mirë në të tri qytetet, ku ka pasur shumë të interesuar për mundësitë që ofron UMIB-i”.

Ndryshe në kuadër të fushatës informuese për të studiuar në UMIB, ku tashmë është hapur konkursi për regjistrim të studentëve në vitin e parë (niveli bachelor) – viti akademik 2020/21, Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun, është duke realizuar një sërë aktivitete. Në këtë kontekst, janë përgatitur fletushka me programet që ofron UMIB, mandej video promovuese që janë shpërndarë në rrjetet sociale, bilborda nëpër qytete, promo në medie etj.

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI ME SHPK. “VIPRINT”



Duke pasur parasysh interesin reciprok, është nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB) dhe SHPK “VIPRINT”. Rektori i UMIB-it, prof.dr.Alush Musaj dhe drejtori i VIPRINT-it, Visar Idrizi, u zotuan se do të angazhohen për promovimin dhe realizimin e një bashkëpunimi në fusha të interesit të përbashkët të dy palëve.

Memorandumi siguron programe të përbashkëta bashkëpunimi dhe ndihmë reciproke teknike në mes të UMIB-it dhe VIPRINT-it, me theks të veçantë të përkrahjes të studentëve të njësive akademike. Palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim me qëllim të aftësimit praktik profesional në fushën e printimit, ku studentëve u mundësohet financim i plotë i studimeve, praktikë profesionale gjatë tri viteve si dhe punësim i garantuar në këtë kompani.

Ndër të tjera, parashihet që VIPRINT-i të ofroj punë praktike për njëzet (20) studentë gjatë vitit akademik, të cilët tregojnë sukses gjatë procesit të përzgjedhjes. Në anën tjetër, UMIB-i do të ndihmoj VIPRINT-in në përgatitjen e studentëve për rekrutim duke u bazuar në kërkesat dhe kriteret e parashtruara.

Poashtu planifikohet që VIPRINT-i të ofroj tre bursa për tre studentët e dalluar, të cilët përzgjidhen nga komisioni i përbashkët e në bazë të rekomandimeve dhe pajtimit të palëve.

28.09.2020